



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E
MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 392/ prot.

Tiranë, më 08 . 11 .2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1634, datë 13.06.2013.

**SHOQËRISË “DHËRMIU - 001” SH.P.K
Fshati Dhërmi, Godinë dy Katëshe, Qendër, Himarë, Vlorë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Dhërmiu - 001” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1634, datë 13.06.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Përroi i Vurlesë”, Fshati Palas, Bashkia Himarë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.230 prot., datë 09.01.2018, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.392, prot., datë 09.01.2018, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1634, datë 13.06.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Përroi i Vurlesë”, Fshati Palas, Bashkia Himarë, për arsye se nuk janë paguar vlerat e garancisë së rehabilitimit të mjedisit për vitet 2014 – 2015, 2015 – 2016, 2016 – 2017 dhe 2017 – 2018 në shumën 331772 lekë.

Leja në fjalë është e pezulluar, pasi është pezulluar leja mjedisore, me shkresën e Ministrisë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave nr.5772, datë 16.07.2013 dhe të tillë status ka aktualisht.

Mungesa e lejes mjedisore është shkak ligjor për revokim përcaktuar në germën “h” të pikës 1 të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1634, datë 13.06.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Përroi i Vurlesë”, Fshati Palas, Bashkia Himarë.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1634, datë 13.06.2013, për mineral gur gëlqeror, në objektin “Përroi i Vurlesë”, Fshati Palas, Bashkia Himarë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

